



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 24 MARS 2016, në orën 17:30

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. MARTA 2016. GODINE, u 17:30 sati

MARS - MART
2016

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033 dhe me Ligjin nr. 04/L-115

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 05/L-094 o izmenu i dopunu Zakona br. 03/L-223 o Sudskom savetu Kosova, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-115 kao i Zakonom br. 05/L-033.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Atëherë, e fillojmë seancën e re të Kuvendit të Republikës së Kosovës me një pikë të vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033 dhe me Ligjin nr. 04/L-115

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033 dhe me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj nënkryetaren e Komisionit Funksional për Legjislacion, zonjën Selvije Halimi, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë edhe raportin, edhe rekomandimet.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 57 pikë 1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24.3.2016, e shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033 dhe me Ligjin nr. 04/L-115 dhe vendosi që për shqyrtimin e projektligjit komisioneve kryesore t'u paraqesë këtë raport me amendamente.

Realisht, Komisioni i ka paraqitur edhe para komisioneve tjera, edhe para deputetëve 2 amendamente dhe që të dyja janë më tepër të karakterit teknik dhe i ftoj deputetët që t'i aprovojnë amendamentet e propozuara nga Komisioni dhe ta aprovojnë tekstin e Projektligjit në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, në këtë projektligj është propozuar vetëm një amendament dhe propozoj që të vazhdojmë me votimin e amendamentit të propozuar sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit Funksional.

Një amendament është, por nëse ndokush ka edhe ndonjë, tregoni! Urdhëro, merre fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Parimisht e përkrahim raportin, por këtu duhet të jenë 2 amendamente, sepse amendamenti 1, në nenin 1 të paragrafit 1, kemi të bëjmë me nenin 1, ndërsa në nenin 1, paragrafi 2, ky amendament i ri shtohet pas nenit 2, që do të thotë të Projektligjit që është plotësim-ndryshim.

(Ndërrhyrje)

Po thashë, nëse mund të më përcjellësh për të më regjistruar. Unë e saktësova, por edhe një herë do ta përsëris.

Kryesues!

Faleminderit shumë për sqarimin edhe tuajin, edhe të Sekretarisë së Kuvendit, edhe për interes të deputetëve dhe të publikut, për të mos pasur dilema. Them se janë 2 amendamente. Pra, janë 2 amendamente! Amendamenti 1, paragrafi shkon në amendamentin 1, që ndryshohet amendamenti 1, dhe që ka të bëjë, do të thotë ku ka qenë “të kryetarëve të gjykatave” të hiqen dhe zëvendësohen me fjalët “kryetarit të gjykatës përkatëse”. Do të thotë, ky është ndryshimi i parë.

Ndërsa në nenin 1, paragrafi 2, që i bie në nenin 2 atje, bëhet paragrafi 1, shtohen fjalët kur kemi të bëjmë “për rregullore, për transfer dhe caktim të gjyqtarëve, nxirret brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi të këtij ligji”.

Domethënë, kështu ka qenë në Komisionin Funkcional, e këtu janë edhe të gjithë anëtarët e Komisionit, dhe këtu janë 2 amendamente. Do të thotë vazhdohet fjalia, por bëhen 2 amendamente. Faleminderit edhe nga ju kryesues edhe nga deputetët që na dëgjuan.

KRYESUESI: Po duhet të jemi të saktë, se sa për të folur kurrfarë sharmi nuk po shoh, asnjë fije. Mirëpo, për saktësi, unë e përcolla këtë zotëriun, a është në komision apo është deputet, s’është me rëndësi. Dhe, atëherë del që Komisioni i ka propozuar 2 amendamente.

Në bazë të asaj që pashë, unë dhe u përpoqa ta përcjell, amendamenti 1 thotë: “Në nenin 1, paragrafi 1 të projektligjit, fjalët “të kryetarëve e të gjykatave” hiqen dhe zëvendësohen me fjalët “kryetarit të gjykatës përkatëse” dhe teksti vazhdon si në projektligj. Pikë! A është kështu 1?

Atëherë, a ka kush kundër? 1 kundër!

A abstenon ndokush?

Atëherë kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2. Sipas Komisionit dhe verifikimeve të mia këtu, është: “Në nenin 1, paragrafi 2, shtohen fjalët “rregullorja për transfer dhe caktim të gjyqtarëve nxirret brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi të këtij ligji”.

A është ky tekst? Faleminderit!

Kush është kundër? Kundër është 1! Naiti.

Kush abstenon? Nuk ka abstenim.

Kalon amendamenti 2.

Dhe, ju lutem zotëri, ma jepni numrin e deputetëve të pranishëm. Edhe një herë për regjistrim, regjistrohuni duke e prekur sustën. Tash e kemi vetëm për t’u regjistruar pjesëmarrja.

Atëherë, të regjistruar të pranishëm janë 65, kurse jeni regjistruar 60. Pyes kush është pa kartelë, pra? A i keni të gjithë? Atëherë, 5 janë të pranishëm si njerëz më shumë se tregohet me letra. Pra, jeni 65, por të regjistruar 60.

Atëherë, janë të pranishëm 65 deputetë të pranishëm dhe ju lus, të bëhemi gati dhe të votojmë - Shqyrtimin e dytë të Projektligjit me ndryshimet dhe plotësimet, që ishin me 2 amendamente që janë bërë.

Ju lus, të përgatitemi për votim dhe votojmë tash! Faleminderit!

Ju njoftoj se 62 deputetë kanë marrë pjesë në votim, 61 janë për, 1 abstenim dhe 0 kundër dhe Kuvendi e miratoi Ligjin 05/L-094 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-033.

Faleminderit dhe mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*